



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. Prot. Br.Prot Prot No.	03-03/1026/16
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	02
Data Datum Date	09.03.2016
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	08/03/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP-03-03/718/16
PËR/ZA/TO:	z. Fatmir GJONBALAJ Drejtor i Prokurimit – Telekom i Kosovës
CC:	z. Agron MUSTAFA Krye Shef Ekzekutiv – Telekom i Kosovës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: “Shërbime të realizimit të reklamave dhe furnizim me material marketingu” me numër prokurimi: TK/16/019/211.

I nderuar z. GJONBALAJ

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nën par. 1.1 dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nën par. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nën par. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Shërbime të realizimit të reklamave dhe furnizim me material marketingu” me numër prokurimi: TK/16/019/211, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t’i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin: “Shërbime të realizimit të reklamave dhe furnizim me material marketingu” me numër prokurimi: TK/16/019/211 në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Ju si zyre e prokurimit pranë autoriteti kontraktues Telekomi i Kosovës keni iniciuar procedurë prokurimi me titull: “Shërbime të realizimit të reklamave dhe furnizim me material marketingu” me numër prokurimi: TK/16/019/211, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 15/02/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit keni paraparë procedurë të hapur për furnizim me kriter çmimi ekonomikisht më i favorshëm. .

Agjencia kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim të mëtutjeshëm. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në kritere që janë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 15/02/2016 tek rubrika IV.2.) KRITERET E DHËNIES, Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, pika 2 Përvoja e kompanisë, keni kërkuar dy kritere: 1.*Përvoja specifike në implementimin e kampanjave televizive të marketingut;* dhe 2. *Përvoja specifike në dizajnim për printim.* Lidhur me nën kriteret 1 dhe 2, Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se nën kritere të tilla nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë nga autoriteti kontraktues si kritere për dhënie të kontratës. Autoriteti kontraktues gjatë përpilimit të dosjes duhet të ketë kujdes për të siguruar që kriteret minimale për kualifikim të jenë kritere që paraprakisht janë të lejuara me ligj. Vendosja e përvojës si kriter i dhënies së kontratës nuk është në përputhje me ligjin. Pra, kriteret në lidhje me përvojat paraprake dhe historikut të kompanisë nuk do të shihen si kritere në procesin e dhënies së kontratës. Në udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik, përcaktohen qartë kriteret e dhënies tek tenderët ekonomikisht më të favorshëm.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 52, Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës të LPP; si dhe pikën 25, Kriteret e Dhënies së Kontratës nga Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik.

Nëse autoriteti kontraktues gjatë procedurës së prokurimit kupton që kriteret e përdorura janë të papërshtatshme për të përcaktuar tenderin ekonomikisht më të favorshëm, përmirësimi i vetëm i situatës është anulimi i procedurës dhe tenderit.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !